



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 750/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada - Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e Elmi Reçica, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimin e apeluar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.750/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Elmi Reçica, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimin 1609A/03D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.750/2021 nga Elmi Reçica, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se votat e pasqyruara nga formulari i llogarijtes për votat e kandidatëve në formularin e rezultatit të kandidatit në qendren e votimit 1609A/03D, janë bartur gabimisht nga fleta llogaritëse për votat e kandidatëve, në FRK të kandidati me nr.18. Apelit ia ka bashkangjitur si dëshmi deklaratën e komisionerit dhe kopjet e formularit për kandidat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Elmi Reçica, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.750/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimin 1609A/03D, fshatin Hoqe e Vogel në Komunën e Rahovecit.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.750/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Elmi Reçica, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje dhe bartje të votave të parashtruesit të apeleve gjatë shënimit të votave në formularin e kandidatëve numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime nga se pritjet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apelet e parashtruara nga Elmi Reçica, i subjektit politik PDK, nuk janë bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë shënimit të votave apo bartje e gabueshme të votave në formularin e listës së kandidatëve për VV e cekura në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 750/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

